Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Alban Susuri	**07.07.2023**	**11.07.2023**	**2023/0473**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.07.2023, OE "N.T.SH." BESI ""- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0473, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve zyrtare te ASK-se" me nr. të prokurimit: "124000-23-2667-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës:shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 50.000.00/36 muaj €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimet ankimore;

1. Neni 6.-Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

2.Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve pika 40.1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP.

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit

-Komisioni i vleresimit ka pase per qellim qe tenderet te ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kete qellim komisioni i vleresimit nuk e ka kryer pasi per mendimin tone ai ka qene subjektiv dhe jo profesional qe arsyen nuk e dim. Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Te RRPPNeni 59. I LPP-se- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

3. NENI 59.- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi Tenderëve.-Komisioni i vleresimit ka pase per qellim qe tenderet te ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kete qellim komisioni i vleresimit nuk e ka kryer pasi per mendimin tone ai ka qene subjektiv dhe jo profesional qe arsyen nuk e dim.

KRITERET PËR VLERËSIM

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata per shërbime te ngjashme, ne vlere minimale prej 75,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).

Deshmit e kerkuara dokumentare;

1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te shërbimeve. Lista duhet te jete e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlera, dhe duhet ti bashkëngjiten a) Kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca të lëshuara nga autoriteti i tillë. b)Kur shërbimi është bërë për një blerës privat uhet të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca të lëshuara nga blerësi i tillë.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i komisionit te vleresimit te ofertave deklaron mbi arsyet e eleminimit qe e mbeshtesin këtë rekomandim;

Komisioni per "Servisimi dhe mirmbajtja e Automjeteve zyrtare te ASK-se me nr 124000-23-2667-2-2-1, per shkak gjendjes se veturave ne përgjithesi dhe vetures SEAT me nr te tablave 3Z-320-01 , i cili eshte servisuar ne Qershor 2022 dhe eshte jo funksional dhe i ri servisuar ne tetor 2022 dhe perseri eshte jo funksional , dhe bazuar ne emailin e dy kolegeve Enis Berisha dhe Hajris Beqiri si ish menaxher te kontrates dhe pergjegjesve te veturave, te cilet jane shprehur te pa kenaqur me sherbimet e ofruara per mirembajtjen /servisimin e

automjeteve sipas kerkesave /nevojave (deshmi jane e-mailit e veturave dhe gjendja e veturave) atehere Operatorin e konsiderojme se nuk eshte i pershtatshem per mirembajtjen e veturave te ASK-se .

Komisioni rekomandon anulimin e procedurave te metejme per tenderin e lartecekur.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Deshmi te kerkuara nga ana e Ekspertit shqyrtues drejtuar AK- ASK-se me dt; 10.07.2023 qe te na sjellet deshmi rreth ketyre menaxhimeve te kontrateve ose qe kan ndonje verejtje me shkrim apo referenc negative apo procesverbal negativ te derguar tek OE, ose eshte lajmeruar ndonje institucion perkates lidhur me mos permbushjen e kontrates.

Republ

Zyra e Kryeminis

Agjencia e Statistikave të Koso

zv.i Kryeshefit Ekzeku
Statistikat Zyrtare te Republikës
06/L-114 Për Zyrtaret Publikë
Nëpunësve Civil, me dt.07.07.20

I. Punëtori Habit
në Departame
atë nga 07.07.2

II. Ky vendim hyr

zv.i Kryeshefit Ekzekutiv i A
793-2023 te dt. 07.07.2023, si dhe
punë, për shkak se menaxheri i pr
performancë jo te mjaftueshme p
e lartcekur ta transferon përkohësi

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **N.T.SH." BESI "**

Pretendimi ankimor 1.

Neni 6.-Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. 2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Përgjigje ne pretendimin nr 1.

Duke u bazuar ne oferten e OE ankues dhe pasi që është një ofertë dhe cmimet janë ne nivelin e tregut mendoj, dhe pasi që nuk mund parashikohet, andaj prentendimi i OE Ankues **eshte i bazuar.**

Pretendimi ankimor 2.

pika 40.1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP ne rregullat dhe LPP thuhet se;

Komisioni i vleresimit ka pase per qellim qe tenderet te ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kete qellim komisioni i vleresimit nuk e ka kryer pasi per mendimin tone ai ka qene subjektiv dhe jo profesional qe arsyen nuk e dim. Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Te RRPPNeni 59. I LPP-se- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Përgjigje ne pretendimin nr 2;

Duke u thirrur ne nenin 40.12 te Rregullores nr 001-2022 -te LPP-së Tenderuesi nuk do të

diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Andaj duke u bazuar ne arsyen e eleminimit te OE dhe kërkeses per sqarime tek AK nga ana e Ekspertit shqyrtues ku nuk kemi marr ndonje pergjigje se a ka ndonjë Referenc negative OE dhe ofertës se prezantuar ku i ploteson nenet 68/69 le LPP-se dhe kritereve te vendosura nga AK andaj pretendimi i OE është **i bazuar**.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N.T.SH." BESI "**

Alban Susuri